




International Documentary
and Short Film Festival



GJAKOVË

Memorandum Bashkëpunimi

mes:

DokuFest

dhe

Komuna e Gjakovës

Drejtoria për Arsim

1. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I MEMORANDUMIT

Ky memorandum synon funksionalizimin e bashkëpunimin afatgjatë në mes të DokuFest dhe Komunës së Gjakovës, përkatësisht Drejtorisë Komunale të Arsimit, për krijimin e një platforme që nxit dhe mbështet shkollat përkatësisht mësimdhënësit në përdorimin e mjeteve audiovizuale në planifikimin dhe zhvillimin e procesit edukativ-mësimor, në shkollat e mesme të larta të komunës, me qëllim të përbushjes të kërkesave dhe rezultateve të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Kosovës, që nxënësit dhe dhe të rinjtë/ të rejat e komunës dhe të Kosovës të përgatiten për t'u përballur me sfidat e shekulli XXI dhe të gjenerojnë dije të reja konkurruese në mënyrë aktive pëtregun global të punës.

2. QËLLIMET SPECIFIKE TË MEMORANDUMIT

Qëllimet specifike të memorandumit janë:

- a) Të funksionalizohen forumet të pavarura të mësimdhënësve dhe nxënësve për diskutim dhe shkëmbim të ideve, për të nxitur debatin publik, arguementues dhe shkencor në përgjithësi dhe në veçanti për rëndësinë e edukimit, përfshirjen sociale dhe edukative të të gjitha komuniteteve përmes artit vizual, filmit dokumentar dhe animacioneve për të rinjtë;
- b) Krijimin dhe funksionalizimin e Klubeve të filmave në Shkollat e Mesme të Larta të Komunës së Gjakovës dhe përgatitjen e mësimdhënësve në përdorimin e filmit në procesin mësimor;
- c) Avancimin e mësimdhënësve në planifikimin dhe zbatimin e metodologjisë së punës edukative me nxënës përmes përdorimit të pakove edukative filmike, kryesisht me tema shoqërore dhe të të drejtave të njeriut;
- d) Pjesëmarrjen aktive të mësimdhënësve në zhvillimin e doracakut për përdorimin e filmit në procesin mësimor përmes punëtorive të organizuara nga DokuFest'

3. OBLIGIMET E PALËVE

DokuFest obligohet që të mbikqyrë dhe ofrojë pajisje dhe material filmik për funksionalizimin e klubeve të filmave duke siguruar filma në tema shoqërore dhe të të drejtave të njeriut;

DokuFest obligohet që të organizojë seanca trajnimi për mësimdhënësit e përfshirë në programe edukative;

Drejtoria e Arsimit – Gjakovë obligohet në informimin e të gjitha shkollave të mesme në komunën përkatëse rrëth qëllimeve të këtyre projekteve me qëllim të përbushjes së qëllimeve specifike;

Shkollat dhe përfaqësuesit e tyre do t'i ndihmojnë DokuFest që së bashku me klubin e filmit në shkollë të organizojë shfaqjen e filmave;

Shkollat do të na ndihmojë në nominimin e mësimdhënësve të cilët do marrin pjesë në seancat e rrëth përdorimit të filmit dokumentarë në procesin mësimor.

4. NDRYSHIMI

Ky Memorandum bashkëpunimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim nga të dyja palët duke u informuar paraprakisht.

5. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEHJEVE

Palët do të përpiken të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga ky Memorandum bashkëpunimi.

6. SHPENZIMET

Kjo marëveshje nuk parasheh shpenzime buxhetore për Komunën e Gjakovës dhe për institucionet vartëse te saj. DokuFest si palë nuk arketon në asnjë mënyrë të mira materiale gjatë implemtimit të projekteve.

7. KOHËZGJATJA E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT


Ky memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët dhe është i vlefshëm deri më


Ky memorandum është përpiluar në 2 kopje identike në gjuhën shqipe. Secila palë merr nga një kopje të nënshkruar nga Komuna e Gjakovës dhe DokuFest.

Data:

Nënshkruesit

DokuFest




Bashkim
Komuna e Gjakovës
(DKA Gjakovë)